



KOMUNA E SHTIMËS

DREJTORIA E PROKURIMIT

Nr. 03/1/055
Datë 27/06/2023

KONTRATË PËR SHËRBIM

Numri i kontratës: 617-23-4810-2-2-1/C554

Komuna Shtimë Rr."Tahir Sinani" tel. 0290-389-016-228 që e përfaqëson Muhadin Halili, Udhëheqës i Zyrës së Prokurimit në njëren anë: dhe

Xhemshir Sejdiya B.I emri i biznesit „N.N.SH Xhema Com, emri tregtar „Gadime e Epërme, Lipjan që e përfaqëson **Xhemshir Sejdiya** drejtor, tel. 044-117-047 „Ofruesi i Shërbimeve në anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për shërbimet e shënuara me poshtë:

Mirëmbajtja e pastertisë, grumbullimi dhe largimi i mbeturinave

Me numër identifikues: 617-23-4810-2-2-1

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kontratës është performimi i shërbimeve në vijim nga ana e Ofruesit të Shërbimeve:

Mirëmbajtja e pastertisë, grumbullimi dhe largimi i mbeturinave

Neni 2 Çmimi

2.1 Çmimi total i shërbimeve duhet të jetë: **41,996.98 € (katër/një/nëntë/nëntë/gjashtë/nëntë/tetë)**

2.2 Çmimi i përmendur në Nenin 2.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Ofruesit të Shërbimeve sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve.

2.3 Pagesat do të bëhen në pajtim me Kushtet e përgjithshme dhe/ose të Veçanta të kontratës.

Neni 3 Rendi i përparësisë i dokumenteve të kontratës

3.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

- (a) Murrëveshja e kontratës; PO
- (b) Kushtet e Veçanta të Kontratës; PO
- (c) Kushtet e Përgjithshme të Kontratës; PO
- (d) Oferta financiare (Përshkrimi i Çmimeve); PO

3.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

Neni 4 Komunikimet

4.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Ofruesit të Shërbimeve nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht.


4.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimit të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimit të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.

4.3 Kudo në kontratë parashikohet për dhënien e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftim të tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njofton", "vërtetojë", "miratoj" ose "vendosë" do të interpretohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendim i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.

4.4 Kjo kontratë është e përgatitur në gjuhën 3 në tri origjinale, dy prej të cilave janë për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinale për Ofruesin e Shërbimeve.


Për Autoritetin Kontraktues

Emri:	Muhadin Halili
Pozita:	Udhëheqës i Zyrës së Prokurimit
Nënshkrimi:	
Data:	27.06.2023
Vula:	



Për Ofruesin e Shërbimeve

Emri:	Xhemshir Sejdija
Pozita:	Drejtor
Nënshkrimi:	
Data:	27.06.2023
Vula:	



KUSHTET E PËRGJITHSHME

Numri i kontratës: 617-23-4810-2-2-1/C554

Neni 1 Përkufizimet

- 1.1 “Kontratë” do të thotë marrëveshje të lidhur ndërmjet Autoritetit kontraktues dhe Ofruesit të Shërbimeve, siç është shënuar në formularin e kontratës të nënshkruar nga palët, duke përfshirë të gjitha shtojcat për këtë dhe të gjitha dokumentet e inkuorporuar me referencë në të.
- 1.2 “Shërbimet” do të thotë shërbimet që do të ekzekutohen nga ana e Ofruesit të Shërbimeve në pajtim me Specifikimet dhe Përshkrimin e Çmimit të përfshira në Tenderin e Ofruesit të Shërbimeve.
- 1.3 “Ofruesi i shërbimeve” është Operatori Ekonomik ose grupi i Operatorëve Ekonomik, i caktuar në formularin e kontratës, që është palë në kontratë dhe i detyruar të kryej detyrat në bazë të marrëveshjes, dhe që për detyrat e kryera do të marrë shumën e rënë dakord në formularin e kontratës.
- 1.4 “Personeli” do të thotë personat e angazhuar nga Ofruesi i Shërbimeve ose nga Nën-kontraktuesi si të punësuar dhe të caktuar për kryerjen e shërbimeve ose të ndonjë pjese të tyre.
- 1.5 “Çmimi i kontratës” do të thotë shuma e deklaruar në Marrëveshjen që përfaqëson shumën totale të pagueshme për ofrimin e Shërbimeve.
- 1.6 “Nënkontraktuesi” do të thotë çdo person fizik, privat ose subjekt i qeverisë, ose kombinimi i tyre, duke përfshirë edhe pasardhësit e tij ligjor ose transferimet e lejuara, për të cilin çdo pjesë e Shërbimeve do të sigurohet ose ekzekutimi i ndonjë pjese të Shërbimeve është nënkontraktuar nga Ofruesi i Shërbimeve.
- 1.7 “Palë” nënkupton Autoritetin Kontraktues ose Ofruesin i Shërbimeve, siç mund të jetë rasti, dhe “Palët” nënkupton të dy prej tyre.
- 1.8 “Autoriteti Kontraktues” nënkupton autoritetin që blen Shërbimet, siç specifikohet në Kontratë.
- 1.9 “KPK” nënkupton Kushtet e Përgjithshme të Kontratës.
- 1.10 “KVK” nënkupton Kushtet e Veçanta të Kontratës.

Neni 2 Ligji i aplikueshëm dhe gjuha

- 2.1 KVK e saktësojnë cili është ligji që i përcakton të gjitha çështjet që nuk janë të mbuluara në kontratë.
- 2.2 Kontrata dhe të gjitha komunikimet e shkruara ndërmjet palëve hartohen në gjuhën e specifikuar në KVK.

Neni 3 Transferimi

- 3.1 Transferimi do të jetë valid vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes të cilës Ofruesi i Shërbimeve e transferon kontratën e vet ose një pjesë të saj të një palë e tretë.
- 3.2 Ofruesi i Shërbimeve nuk mundet që, pa miratim paraprak me shkrim nga Autoriteti kontraktues, ta transferojë kontratën ose një pjesë të saj, ose ndonjë përfitim apo interes nga ajo, përveç në këto raste:
- a) kur ka ngarkesë për pagesë, në favor të bankierëve të Ofruesit të Shërbimeve, të shumave që duhet të paguhet ose që do të bëhen botshis sipas kontratës; ose
 - b) në rast të dhënies së të drejtës së Ofruesit të Shërbimeve siguruesve të Ofruesit të Shërbimeve për të kërkuar pagesën nga ndonjë person tjetër i detyruar në rastet kur siguruesit e kanë shkarkuar humbjen ose detyrimin e Ofruesit të Shërbimeve.
- 3.3 Për qëllimet e nenit 3.2, aprovimi i një transferimi nga Autoriteti kontraktues nuk do ta lirojë Ofruesin e Shërbimeve nga obligimet e veta për pjesën e kontratës që tashmë është realizuar ose për pjesën që nuk është bartur.
- 3.4 Pranuesit e dispozitave të kontratës duhet të plotësojnë kriteret e përshtatshmërisë që zbatohen për dhënien e kontratës përveç në raste kur transferimi bëhet në bankë apo kompani të sigurimit ose institucion tjetër financiar.

Neni 4 Nën-kontraktimi

- 4.1 Nënkontrata është valide vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes së cilës Ofruesi i Shërbimeve ia beson realizimin e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë.
- 4.2 Elementet e kontratës që do të nënkontraktohen dhe identiteti i nënkontraktuesve i bëhen të ditura

Autoritetit kontraktues me rastin e dorëzimit të ofertës. Në rast të ndryshimit të nënkontraktuesve gjatë implementimit të kontratës, Ofruesi i Shërbimeve duhet të njoftoj me shkrim Autoritetin Kontraktues. Autoriteti kontraktues do ta lajmërojë Ofruesin e Shërbimeve për vendimin e vet brenda 30 ditë pune nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi. Ofruesi i Shërbimeve nuk nënkontraktion pa autorizim me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Te gjithë nënkontraktuesit e propozuar duhet të përmbushin kërkesat e përshatshmërisë.

4.3 Autoriteti kontraktues nuk njihë lidhje kontraktore ndërmjet vetes dhe nënkontraktuesve megjithatë mund të siguroj, ku e konsideronë si të nevojshme, pagesat direkte për nënkontraktorët.

4.4 Ofruesi i Shërbimeve është përgjegjës për aktet, gabimet dhe neglizhencën e nënkontraktuesve të vet si dhe të agjentëve ose të punësuarve, në të njëjtën mënyrë si po të ishin akte, gabime ose neglizhencë e Ofruesit të Shërbimeve, agjentëve të tij ose punëtorëve të tij. Aprovimi i nënkontraktimit të ndonjë pjese të kontratës ose aprovimi i nënkontraktuesit nga ana e Autoritetit kontraktues nuk e liron Ofruesin e Shërbimeve nga obligimet e tij sipas kontratës.

Neni 5 Tatimet dhe Doganat

5.1 Ofruesi i Shërbimeve është përgjegjës për të gjitha taksat dhe doganat në pajtim me Ligjin e Republikës së Kosovës.

5.2 Ofruesi i Shërbimeve, Nënkontraktuesit, dhe Personeli i tyre do t'i paguaj ato taksa, dogana, tarifa dhe detyrime të tjera që mund të vendosen sipas ligjit në fuqi, shumata e të cilave mendohet të ketë qenë e përfshirë në çmimin e kontratës.

Neni 6 Fillimi dhe Përfundimi i shërbimeve

6.1 Kjo kontratë hyn në fuqi në datën e nënshkrimit të kontratës nga të dy palët ose në një datë tjetër të mëvonshme siç mund të ceket në KVK.

6.2 Para fillimit të Shërbimeve, Ofruesi i Shërbimeve do të dorëzoj Autoritetit Kontraktues për miratim një Program që tregon metodat, aranzhimet, rendin dhe kohën për të gjitha aktivitetet. Shërbimet do të kryhen në pajtim me programin e miratuar.

6.3 Ofruesi i Shërbimeve do të filloj shërbimet sa më shpejt që është arsyeshëm e mundur pas marrjes së urdhrimit me ekspeditën e duhur dhe pa vonesë.

6.4 Ofruesi i Shërbimeve do të përfundoj aktivitetet në datën e planifikuar të përfundimit, siç është e specifikuar në KVK. Nëse Ofruesi i Shërbimeve nuk i përfundon aktivitetet në datën e planifikuar të përfundimit, ai do të jetë përgjegjës për të paguar dëmet e likuiduara. Në këtë rast, Data e Përfundimit do të jetë data e përfundimit të të gjitha aktiviteteve.

6.5 Vendi i kryerjes së shërbimeve është i përcaktuar në KVK.

6.6 Përveç nëse palët pajtohen që të bëhet ndryshe, ekzekutimi i kontratës do të fillojë jo më vonë se 90 ditë pas njoftimit të dhënies së kontratës. Pas kësaj date Ofruesi i Shërbimeve do të ketë të drejtë të mos e ekzekutojë kontratën dhe ta marrë ndërprerjen e saj ose kompensimin për dëmin që i është shkaktuar. Ofruesit të Shërbimeve do t'i merret kjo e drejtë, përveç nëse e ushtron brenda 30 ditësh pas skadimit të periudhës 90-ditore.

Neni 7 Zgjatja e periudhës së përfundimit

7.1 Ofruesi i Shërbimeve mund të kërkojë zgjatje të periudhës së ekzekutimit nëse realizimi i kontratës së tij vonohet, ose pritet se do të vonohet, për ndonjërin nga këto arsye:

- a) Autoriteti kontraktues ka dështuar t'i plotësojë obligimet e veta sipas kontratës;
- b) forca madhore siç është e definuar në Nenin 8;

7.2 Brenda 15 ditëve me të kuptuar se një vonesë mund të ndodhë, Ofruesi i Shërbimeve do të njoftoj Autoritetin Kontraktues mbi qëllimin e tij që të bëjë një kërkesë për zgjatjen e periudhës së realizimit për të cilën ai konsideron se ka të drejtë dhe, përveçse kur është rënë dakord ndryshe ndërmjet ofruesit të shërbimeve dhe Autoritetit Kontraktues, brenda 30 ditëve nga e njëjta pikë në kohë të sigurojë Autoritetin Kontraktues me hollësi të plotë në mënyrë që të mund të shqyrtohet kërkesa.

7.3 Brenda 30 ditëve nga marrja e hollësive të përmendura në 7.2, Autoriteti Kontraktues me anë të njoftimit me shkrim do t'i lejoj Ofruesit të Shërbimeve zgjatjen e periudhës së ekzekutimit siç mund të arsyetohet, ose në mënyrë prospektive dhe retrospektive, ose të informoj Ofruesin e Shërbimeve që ai nuk ka të drejtë në zgjatje.

Neni 8

Forca madhore

8.1. Asnjëra palë nuk konsiderohet se ka bërë shkelje të obligimeve të saj sipas kontratës nëse realizimi i obligimeve të tilla parandalohet nga ndonjë ngjarje e shkaktuar nga një forcë *madhore* që shkaktohet pas datës së njoftimit mbi dhënie të kontratës ose kur kontrata hyn në fuqi.

8.2. Termi "forcë madhore" do të thotë veprimet e zotit, goditjet, mbylljet e objektit ose çrregullimet tjera industriale, veprimet e armikut publik, luftërat qofshin të deklaruara ose jo, bllokadat, rebelimet, rastet e dhunës, epidemitë, rrëshqitjet e tokës, tërmetet, shtrëngatat, vetëtimat, vërshimet, erozionet, trazirat civile, eksplozimet dhe ndonjë ngjarje tjetër e ngjashme e paparashikuar që është përtej kontrollit të palëve dhe nuk mund të përballohet as me kujdesin e duhur.

8.3. Pala e ndikuar nga një ngjarje e forcës madhore do të marrë të gjitha masat e arsyeshme për të mënjanuar paaftësinë e një pale të tillë që të përmbush detyrimet e saj tani e tutje me një vonesë minimale.

8.4. Ofruesi i Shërbimeve nuk do të jetë përgjegjës për dëmet e likuiduara ose ndërprerje nëse vonesa e tij në realizimin ose dështimi për të realizuar obligimet e tij me kontratë është rezultat i një ngjarjeje të forcës madhore. Autoriteti kontraktues nuk do të jetë i detyruar të paguajë interes për pagesat e vonuara, për mosrealizim ose për ndërprerje nëse vonesa e Autoritetit kontraktues ose lloj tjetër i dështimit për të kryer obligimet e tij është rezultat i forcës madhore.

8.5. Nëse ndonjëra palë konsideron se ndonjë rrethanë e forcës madhore ka ndodhur e cila mund të ndikojë në realizimin e obligimeve të saj, menjëherë do ta lajmërojë palën tjetër, duke dhënë të dhëna detaje mbi natyrën, kohëzgjatjen e mundshme dhe efektin që kanë gjasa ta kenë rrethanat. Përveç nëse udhëzohet ndryshe nga Menaxheri i Projektit me shkrim, Ofruesi i Shërbimeve do të vazhdojë t'i realizojë obligimet e tij sipas kontratës përdorësa është mjaft praktike, dhe të angazhojë të gjitha mjetet e arsyeshme alternative për të plotësuar ndonjë obligim që ngjarja e forcës madhore të mos e pengojë atë gjatë punës. Ofruesi i Shërbimeve nuk do të zbatojë mjete të tilla alternative përveç nëse udhëzohet ta bëjë këtë nga Menaxheri i Projektit.

Neni 9

Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti kontraktues

9.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Ofruesit të Shërbimeve 14 ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet e mëposhtme:

- (a) Ofruesi i Shërbimeve dështon në përmbushjen brenda një afati të arsyeshëm të paralajmërimit të dhënë nga autoriteti kontraktues që kërkon nga ai të evitohet ndonjë neglizhencë apo dështim për të realizuar obligimet e veta sipas kontratës, dhe të cilat ndikojnë në mënyrë serioze në realizimin e duhur dhe me kohë të shërbimeve;
- (b) Ofruesi i Shërbimeve refuzon ose është neglizhent në realizimin e urdhrave administrative të dhëna nga autoriteti kontraktues;
- (c) Ofruesi i Shërbimeve ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga Autoriteti kontraktues;
- (d) Ofruesi i Shërbimeve falimenton ose është duke u mbyllur; punët e tij janë duke u administruar nga gjykatat, ka hyrë në marrëveshje me kredituesit, ka pezulluar aktivitetet biznesore, i nënshtrohet procedurave ligjore lidhur me ato çështje, ose është në ndonjë situatë analoge që shkaktohet nga ndonjë procedurë e ngjashme e paraparë në legjisllacionin apo në rregulloret nacionale;
- (e) Ofruesi i Shërbimeve është dënuar për një shkelje që ka të bëjë me sjelljen profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e *res judicata*;
- (f) Ofruesi i Shërbimeve është shpallur fajtor për sjellje të rëndë të keqe jo profesionale të dëshnuar me çfarëdo mjeti të cilin mund ta vërtetoj Autoriteti kontraktues;
- (g) Ofruesi i Shërbimeve i është nënshtuar një gjykimi që ka forcën e *res judicata* për mashtrim, korrupsion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale;
- (h) të gjitha modifikimet organizative që përfshijnë ndryshime në personalitetin ligjor, natyrën ose kontrollin e Ofruesit të Shërbimeve, përveç nëse këto modifikime regjistrohen në suplementin e kontratës;
- (i) shfaqet ndonjë paaftësi tjetër ligjore që i pengon realizimit të kontratës;
- (j) Ofruesi i Shërbimeve nuk arrin të japë garancinë ose sigurimin e kërkuar, ose nëse personi që e jep garancinë apo sigurimin më të hershëm të kërkuar në kontratën e tanishme nuk është në gjendje t'i plotësojë zotimet e tij.

9.2 Ndërprerja do të bëhet pa paragjykim ndaj të drejtave apo mundësive tjera të Autoritetit kontraktues dhe Ofruesit të Shërbimeve sipas kontratës. Autoriteti kontraktues, pas kësaj mund të nënshtrojë ndonjë kontratë tjetër me një palë të tretë në emër të Ofruesit të Shërbimeve.

9.3 Autoriteti Kontraktues, pas lëshimit të njoftimit të ndërprerjes së kontratës, do ta udhëzojë Ofruesin e Shërbimeve që të ndërmarrë hapa të menjëhershëm për ta përmbyllur ekzekutimin e shërbimeve në mënyrë të shpejtë dhe të rregullt dhe për t'i zvogëluar në minimum shpenzimet.

9.4 Në rast të ndërprerjes, autoriteti kontraktues, sa më shpejt që të jetë e mundur dhe në prani të Ofruesit të Shërbimeve ose të përfaqësuesve të tij ose duke u bërë atyre thirrjen e duhur, do ta përgatisë një raport mbi shërbimet e kryera. Do të përgatitet edhe një deklaratë e parave që duhet t'i paguhet Ofruesit të Shërbimeve dhe parave që i ka borxh Ofruesi i Shërbimeve Autoritetit kontraktues në datën e ndërprerjes së kontratës.

9.5 Autoriteti kontraktues nuk do të jetë i obliguar të bëjë pagesa tjera për Ofruesin e Shërbimeve derisa të jenë përfunduar shërbimet, ndërsa Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë të marrë nga Ofruesi i Shërbimeve koston ekstra, nëse ka, për të siguruar ofruesin e shërbimeve ose do të paguajë shumën që duhet t'i paguhet Ofruesit të Shërbimeve para ndërprerjes së kontratës.

9.6 Nëse Autoriteti kontraktues e ndërpret kontratën, ai do të ketë të drejtë të marrë nga Ofruesi i Shërbimeve humbjet që i janë shkaktuar nën kushtet e kontratës.

Neni 10 Ndërprerja nga ana e Ofruesit të Shërbimeve

10.1 Ofruesi i Shërbimeve, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues;

- a. nuk arrin t'i paguajë Ofruesit të Shërbimeve shumat që duhet të paguhet në ndonjë certifikatë të lëshuar nga personi i autorizuar pas skadimit të afatit të fundit;
- b. vazhdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta edhe pas rikujtimeve të përsëritura; ose
- c. ose, si rezultat i Forcës Madhore, Ofruesi i Shërbimeve është i paafitë të kryej një pjesë materiale të Shërbimeve për një periudhë prej jo më pak se gjashtëdhjetë (60) ditë.

10.2 Ndërprerja do të bëhet pa paragjykim për ndonjë të drejtë apo autoritet tjetër sipas kontratës së Autoritetit kontraktues dhe Ofruesit të Shërbimeve.

10.3 Në rast të ndërprerjes sipas paragrafit (a) dhe (b) të Seksionit 10.1, Autoriteti kontraktues do ta paguajë Ofruesin e Shërbimeve për humbje ose dëm që mund t'i jetë shkaktuar Ofruesit të Shërbimeve.

Neni 11 Obligimet e Ofruesit të Shërbimeve

11.1 Ofruesi i Shërbimeve do të kryej Shërbimet sipas kontratës me kujdes, efikasitet dhe zell, në përputhje me praktikat më të mira profesionale.

11.2 Ofruesi i Shërbimeve duhet të veprojë sipas urdhrave administrative që i jep autoriteti kontraktues. Nëse Ofruesi i Shërbimeve konsideron se kërkesa e një urdhri administrativ shkon përtej fushëveprimit të kontratës, ai, duke iu ekspozuar dënimin për shkelje të kontratës, do ta njoftojë autoritetin kontraktues për këtë duke i paraqitur arsyet e tij brenda 30 ditësh pas pranimit të urdhrit. Ekzekutimi i urdhrit administrativ nuk do të pezullohet për shkak të këtij njoftimi.

11.3 Ofruesi i Shërbimeve duhet t'i respektojë dhe të veprojë sipas të gjitha ligjeve dhe rregulloreve në fuqi në Republikën e Kosovës dhe do të sigurojë që personeli i tij, të afërmit e tyre, dhe punëtorët vendorë të tij gjithashtu t'i respektojnë dhe të veprojnë sipas këtyre ligjeve dhe rregulloreve.

11.4 Ofruesi i Shërbimeve duhet t'i trajtojë të gjitha dokumentet dhe informatat e marra lidhur me kontratën si private dhe konfidenciale. Përveç në rastet kur kjo është e nevojshme për qëllime të ekzekutimit të kontratës, ai nuk do të publikojë ose shpalosë asnjë detaj të kontratës pa pajtim paraprak me shkrim nga Autoriteti kontraktues.

11.5 Nëse Ofruesi i Shërbimeve është konsorcium i dy ose më tepër personave, të gjithë personat e tillë do të jenë bashkërisht dhe vazhdimisht të obliguar t'i plotësojnë kushtet e kontratës. Personi i caktuar nga konsorciumi që të veprojë në emër të tij për qëllime të kësaj kontrate do të ketë autoritetin që të lidh konsorciumin. Përbërja e grupit nuk do të ndryshohet pa miratim paraprak me shkrim nga Autoriteti kontraktues.

11.6 Ofruesi i Shërbimeve do të punësoj personelin kyç të identifikuar në tender e tij për të kryer funksionet e përcaktuara në tenderin e tij. Për më tepër, gjatë ekzekutimit, dhe në bazë të kërkesës me shkrim dhe të arsyetuar, autoriteti kontraktues mund të kërkojë për një zëvendësim nëse vlerëson se një anëtar i stafit është i pafektshëm ose nuk kryen detyrat e tij sipas kontratës. Autoriteti kontraktues do të miratojë çdo zëvendësim të propozuar të personelit kryesor, vetëm nëse kualifikimet e tyre përkatëse dhe aftësitë janë thelbsisht të barabarta ose më të mirë se ato të identifikuar.

Neni 12 Obligimet e Autoriteti Kontraktues

12.1 Autoriteti kontraktues do t'i ofrojë ofruesit të shërbimeve menjëherë ndonjë informacion dhe/ose dokumentacion në dispozicion të tij, që mund të jenë relevante për zbatimin e kontratës. Dokumente të tilla do t'i kthehen Autoritetit Kontraktues në fund të periudhës së zbatimit të detyrave.

12.2 Autoriteti Kontraktues do të bashkëpunoj sa më shumë që është e mundur me Ofruesin e Shërbimeve për t'i siguruar informacione që ky i fundit mund t'i kërkojë në mënyrë të arsyeshme për kryerjen e kontratës.

12.3 Autoriteti Kontraktues do të caktoj "Menaxherin e Projektit", i ceku në KVK, i cili do të jetë përgjegjës për mbikëqyrjen e kryerjes së shërbimeve gjatë gjithë kohës dhe për raportimin e çdo hollësie Autoritetit Kontraktues.

Neni 13 Dëmet e likuiduara

13.1 Ofruesi i Shërbimeve do të paguajë dëmet e likuiduara Autoritetit Kontraktues në normën ditore të cekur në KVK për çdo ditë që Data e Përfundimit është me vonë se Data e Kërkuar e Përfundimit. Shuma totale e dëmeve të likuiduara nuk duhet të tejkaloj shumën e përcaktuar në KVK. Autoriteti Kontraktues mund të zbresë dëmet e likuiduara nga pagesat për shkak të Ofruesit të Shërbimeve. Paga e dëmeve të likuiduara nuk do të ndikojë në detyrimet e Ofruesit të Shërbimeve.

13.2 Nëse Data e përfundimit është zgjatur pasi që janë paguar dëmet e likuiduara, Autoriteti kontraktues do të përmirësojë çdo pagesë të tepërt të dëmeve të likuiduara nga ofruesi i shërbimit, duke rregulluar certifikatën e ardhshme të pagesës.

Neni 14 Siguria e ekzekutimit

14.1 Ofruesi i Shërbimeve do të, jo më vonë se dita e nënshkrimit të kontratës, furnizojë Autoritetin Kontraktues me siguri për ekzekutim të plotë dhe të mirë të kontratës. Shuma e sigurisë do të saktësohet në KVK. Siguria e ekzekutimit do të ndalet nga pagesa e Autoritetit kontraktues për çfarëdo humbjeje që është pasojë e mosekzekutimit të plotë dhe të duhur të obligimeve kontraktore nga ana e Ofruesit të Shërbimeve.

14.2 Siguria do të vazhdojë të jetë valide 30 ditë pas lëshimit të Certifikatës së Përfundimit.

14.3 Siguria e ekzekutimit të kontratës do të jetë në formën e dhënë në pjesën IV të kontratës.

Neni 15 Sigurimi që do të merret nga ofruesi i shërbimeve

15.1 Ofruesi i Shërbimeve do të marrë dhe do të ruajë, dhe do të shkaktojë Nënkontraktorët të marrin dhe ruajnë, me shpenzimet e tyre, por në bazë të kushteve të miratuara nga Autoriteti Kontraktues, sigurimin nga rrezikët, dhe për mbulim, siç do të specifikohet në KVK.

15.2 Ofruesi i Shërbimeve, me kërkesë të Autoritetit Kontraktues, do të ofrojë dëshmi për Autoritetin Kontraktues që sigurimi i tillë është marrë dhe ruajtur dhe se primet e tanishme janë paguar.

Neni 16 Parimet e përgjithshme të pagesës

16.1 Pagesat do të bëhen në Euro. Metoda dhe kushtet e pagesës që duhet t'i bëhet Ofruesit të Shërbimeve sipas kësaj Kontrate do të specifikohen në KVK.

16.2 Pagesat që duhet të bëhen sipas faturës së lëshuar nga Ofruesi i Shërbimeve do të bëhen në llogarinë bankare të dhënë në Pjesën V, **Identifikimi Financiar**, i kësaj kontrate që e plotëson Ofruesi i Shërbimeve. I njëjti formular, që i bashkëngjitet kërkesës për pagesë, duhet të përdoret për t'i raportuar ndryshimet në llogarinë bankare.

16.3 Shumat duhet të paguhet brenda jo më shumë se 30 ditësh kalendarike nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

16.4 Periudha prej 30-ditësh mund të pezullohet duke e lajmëruar Ofruesin e Shërbimeve që kërkesa për pagesë nuk mund të plotësohet sepse shuma nuk do të paguhet për shkak se nuk janë dorëzuar dokumentet e duhura përmbajtësore ose sepse ka dëshmi që shpenzimi mund të mos jetë legjitim. Në rastin e fundit mund të bëhet një inspektim i menjëhershëm për qëllim të kontrollimeve tjera. Ofruesi i Shërbimeve do të japë sqarime, modifikime apo informata të tjera brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha e pagesës do të llogaritet nga data në të cilën është regjistruar kërkesa për pagesë e përgatitur në mënyrën e duhur.

16.5 Pasi që të ketë kaluar afati i fundit i dhënë në Nenin 16.3, Ofruesi i Shërbimeve mundet që, brenda dy muajsh pas pagesës së vonuar, të kërkojë interesin për pagesë të vonuar me normë të re-zbritje që zbatohet nga Banka Qendrore e Kosovës në ditën e parë të muajit në të cilin ka skaduar afati i fundit, plus shtatë pikë të përqindjes. Interesi për pagesë të vonuar do të zbatohet për kohën që kalon ndërmjet datës së afatit të fundit të pagesës (nuk përfshihet) dhe datës në të cilën debitohet llogaria e Autoritetit kontraktues (përfshihet).

16.6 Të gjitha mos pagesat pas 90 ditësh nga skadimi i periudhës së dhënë në Nenin 16.3 do t'i japin të drejtë Ofruesit të Shërbimeve që ose të mos e realizojë kontratën, ose ta ndërpresë atë, me paralajmërim prej 30 ditësh për Autoritetin kontraktues.

Neni 17 Kontrolli i kualitetit

17.1 Parimi dhe modalitetet e Inspektimit të Shërbimeve nga Autoriteti kontraktues do të jenë si në KVK. Autoriteti kontraktues do të kontrollojë punën e ofruesit të shërbimeve dhe të njoftojë atë për çdo defekt që është gjetur. Kontrolli i tillë nuk do të ndikojë në përgjegjësitë e ofruesit të shërbimeve. Autoriteti Kontraktues mund të udhëzojë ofruesit e shërbimeve të kërkojnë një defekt dhe të zbulojnë dhe provojnë çdo shërbim që Autoriteti Kontraktues konsideron se mund të ketë një defekt. Periudha garantuese e defekteve është si në KVK.

Neni 18 Korrigjimi i defekteve

18.1 Autoriteti kontraktues do të njoftojë ofruesit e shërbimeve për çdo Defekt para përfundimit të kontratës. Periudha garantuese e defekteve do të zgjatet për aq kohë sa Defektet të korrigjohet.

18.2 Sa herë njoftimi për një defekt është dhënë, ofruesi i shërbimeve duhet të përmirësoj defektin e njoftuar brenda kohës së specifikuar në njoftimin e Autoritetit Kontraktues.

18.3 Nëse ofruesi i shërbimeve nuk e ka korrigjuar defektin brenda kohës së specifikuar në njoftimin e Autoritetit Kontraktues, Autoriteti Kontraktues do të vlerësojë koston e korrigjimit të defektit, ofruesi i shërbimeve do të paguaj këtë shumë, dhe do pasoj një dënim për mungesë Ekzekutimi që llogaritet siç përshkruhet në nenin 13.1.

Neni 19 Konsekuencat e Shkeljes se kontratës

19.1 Pala ka shkelë kontratën nëse nuk arrin të shlyejë ndonjë nga obligimet e veta me kontratë siç është cekur në Nenin 9 dhe 10.

19.2 Në rastet kur ndodh një shkelje e kontratës, pala e dëmtuar do të ketë të drejtë për këto kompensime:

- a) dëmet; dhe/ose
- b) ndërprerjen e kontratës.

19.3 Përveç masave të sipërpërmendura, mund të jepen dëmshpërblime. Ato mund të jenë:

- a) Dëme të përgjithshme; ose
- b) Dëme të likuidueshme.

19.4 Mbulimi i dëmeve, pagesat apo shpenzimet që rezultojnë nga zbatimimi i masave të parapara në këtë nen do të zbatohen duke u zbritur nga shumat që duhet t'i paguhet Ofruesit të Shërbimeve, nga depozita, ose me pagesë nga siguria.

Neni 20 Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve

20.1 Palët duhet t'i bëjnë të gjitha përpjeke për të zgjidhur në mënyrë miqësore të gjitha mosmarrëveshjet që mund të ndodhin ndërmjet tyre. Sapo të shfaqet ndonjë mosmarrëveshje, palët do ta lajmërojnë njëra tjetrën me shkrim për qëndrimet e tyre në mosmarrëveshje dhe për ndonjë zgjidhje që ata konsiderojnë se është e mundshme. Nëse cilado palë e sheh të dobishme, palët do të takohen dhe të mundohen ta zgjidhin mosmarrëveshjen. Pala do të i përgjigjet kërkesës për zgjidhje miqësore brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha maksimale që jepet për arritjen e kësaj zgjidhjeje do të jetë 30 ditë nga fillimi i procedurës. Nëse përpjekja për të arritur zgjidhje miqësore dështon ose nëse pala dështon të përgjigjet me kohë ndaj kërkesave për zgjidhje, të dyja palët do të jenë të lira të vazhdojnë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes duke e lajmëruar tjetrën.

20.2 Nëse procedura e zgjidhjes miqësore të mosmarrëveshjes dështon, palët mund të merren vesh të përpqen të pajtohen përmes institucionit të specifikuar në KVK. Nëse nuk mund të arrihet zgjidhja brenda 30 ditësh pas fillimit të procedurës së pajtimit, secila palë do të ketë të drejtë të vazhdojë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

Neni 21 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

21.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë:

- a) vendim nga gjyqi; ose
- b) kurdo qe palët pajtohen vendim arbitrimi në pajtim me KVK.

21.2 Para nënshkrimit të kontratës palët duhet të vendosin për mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.

Neni 22 Dëmshpërblimi

22.1 Ofruesi i shërbimeve do të mbrojë dhe do të dëmshpërblejë Autoritetin Kontraktues, zyrtaret e tij dhe ish zyrtaret, drejtoret, punonjësit dhe agjentet e tij dhe do të jetë përgjegjës për të gjitha shpenzimet, humbjet, dëmet, dhe pagesat e shkaktuara nga Autoriteti Kontraktues, duke përfshirë por jo kufizuar shpenzimet e tarifës së avokateve dhe shpenzimet në lidhje me: neglizhencën ose keqpërdorimet e qëllimshme nga ana e ofruesit të shërbimeve, shkeljet apo shkeljet e pretenduar nga prezantimet e Ofruesit të Shërbimeve, pretendimet nga një palë e tretë se sigurimi i atyre shërbimeve nga ofruesi i shërbimit apo shfrytëzimi i tyre nga apo në emër të Autoritetit Kontraktues apo përdorimi ose sigurrimi i ndonjë aseli të siguruar nga ofruesi i shërbimeve në lidhje me kryerjen e shërbimeve shkel të drejtat e pronësisë intelektuale të asaj pale të tretë.

KUSHTET E VEÇANTA

Numri i kontratës: 617-23-4810-2-2-1/C554

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Nr. Nenit	
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë Shqipe
Fillimi dhe Përfundimi i shërbimeve	6.1	Data e Fillimit të fillimit është 27.06.2023
	6.4	Data e Përfundimit është :31 03 2024
	6.5	Vendi i kryerjes së shërbimeve është <i>Komuna Shtimes me të gjitha lokalitetet që paraqitet nevoja</i> .
Obligimet e Autoritetit Kontraktues	12.3	Menaxheri i projektit emrohet nga ZKA
Dëmet e likuiduara	13.1	Norma e dëmeve të likuiduara është 0.25 % në ditë, për shërbime të pa kryera . Shuma maksimale e dëmeve të likuiduara për tërë kontratën është 10 % të çmimit final të kontratës.
Siguria e ekzekutimit	14.1	Shuma e Sigurisë së ekzekutimit është: 10 % e vlerës së kontratës për një periudhë për deri më 30.04.2024 nga nënshkrimi i kontratës .
Sigurimi që do të merret nga ofruesi i shërbimeve	15.1	Rreziqet dhe mbulimi nga sigurimi do të jenë: a) Automjeti motorik i Palës së Tretë OE b) Përgjegjësia e Palës së Tretë OE c) Përgjegjësia ndaj punëdhënësit dhe kompensimi i punëtorëve OE d) Përgjegjësia profesionale <i>Bie mbi OE</i> e) Humbja ose dëmtimi i pajisjeve dhe pronës <i>Bie mbi OE</i>
Parimet e përgjithshme të pagesës	16.1	Orari i pagesës do të jetë: <i>OE, sjellë faturen e rregullt , raportin e menaxherit të kontratës për shërbimet kryera , pastaj bëhet pagesa në bazë të LPP, dhe financave publike</i>
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjes	20.2	<i>Për çdo mosmarrëveshje eventuale në mes AK dhe OE do të zgjidhen me marrëveshje</i>
Zgjidhja e mosmarrëveshjes me procedurë gjyqësore	21.1	a) Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet <i>gjykatën kompetente</i> në pajtim me ligjin në Kosovë.

Paramasa: Grumbullimi i mbeturinave në komunën e Shtimes

Rruga Adem Jashari													
Nr.	Përshkrimi i aktivitetit	nm	Sasia	Çmimi nm	Çmimi total (vjetor)	Nr. i aktiviteteve (vjetore)	Numri i aktiviteteve të ndërrmarra përgjatë periudhës së aktiviteteve të mirëmbajtjes						
							Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor
1	Grumbullimi dhe largimi i mbeturinave (duke përfshirë edhe zbrazjen e shportave) sipas specifikimit teknik. Pastrimi duhet të bëhet në mëngjes.	Ari	303	0.20 €	11,211.00 €	185	25	25	25	25	25	25	10
2	Pastrimi i grafitëve në sipërfaqet mureve. Pastrimi bëhet sipas specifikimit teknik sipas urdhërimit të menaxherit	m ²	10	0.01 €	0.40 €	4	1	1	1	0	0	0	0
3	Mirëmbajtja e mobilierisë urbane - Ulëset në rast të dëmtimit. Sipas specifikimit teknik dhe urdhërimit të menaxherit	Copë	3	0.01 €	0.32 €	4	1	1	1	0	0	0	0
4	Mirëmbajtja e mobilierisë urbane - Shportat në rast të dëmtimit. Sipas specifikimit teknik dhe urdhërimit të menaxherit	Copë	3	0.01 €	0.32 €	4	1	1	1	0	0	0	0
					11,212.04 €								

Rruga Tahir S nani													
Nr.	Përshkrimi i aktivitetit	nm	Sasia	Çmimi nm	Çmimi total (vjetor)	Nr. i aktiviteteve (vjetore)	Numri i aktiviteteve të ndërrmarra përgjatë periudhës së aktiviteteve të mirëmbajtjes						
							Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor
1	Grumbullimi dhe largimi i mbeturinave (duke përfshirë edhe zbrazjen e shportave) sipas specifikimit teknik. Pastrimi duhet të bëhet në mëngjes.	Ari	322	0.28 €	10,722.60 €	185	25	25	25	25	25	25	10
2	Pastrimi i grafitëve në sipërfaqet mureve. Pastrimi bëhet sipas specifikimit teknik sipas urdhërimit të menaxherit	m ²	10	0.01 €	0.40 €	4	1	1	1	0	0	0	0
3	Mirëmbajtja e mobilierisë urbane - Ulëset në rast të dëmtimit. Sipas specifikimit teknik dhe urdhërimit të menaxherit	Copë	20	0.01 €	0.80 €	4	1	1	1	0	0	0	0
4	Mirëmbajtja e mobilierisë urbane - Shportat në rast të dëmtimit. Sipas specifikimit teknik dhe urdhërimit të menaxherit	Copë	20	0.01 €	1.20 €	4	1	1	1	0	0	0	0
					10,725.00 €								

Rruga Komandant Kumanova											Numri i aktiviteteve të ndërrmarra përgjatë periudhës së aktiviteteve të mirëmbajtjes					
Nr.	Përshkrimi i aktivitetit	nm	Sas z	Çmimi nm	Çmimi total (vjetor)	Nr. i aktiviteteve (vjetore)	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor		
1	Grumbullimi dhe largimi i mbeturinave (duke përfshirë edhe zbrazjen e shportave) sipas specifikimit teknik. Pastrimi duhet të bëhet në mënygjes.	Ari	180	0.12 €	3,996.00 €	185	25	25	25	25	25	25	25	10		
2	Pastrimi i grafitëve në sipërfaqet mureve. Pastrimi bëhet sipas specifikimit teknik sipas urdhërimit të menaxherit	m ²	5	0.01 €	0.20 €	4	1	1	1	1	0	0	0	0		
3	Mirëmbajtja e mobilierës urbane - Ulëset në rast të dëmtimit. Sipas specifikimit teknik dhe urdhërimit të menaxherit	Copë	10	0.01 €	0.40 €	4	1	1	1	1	0	0	0	0		
4	Mirëmbajtja e mobilierës urbane - Shportat në rast të dëmtimit. Sipas specifikimit teknik dhe urdhërimit të menaxherit	Copë	10	0.01 €	0.40 €	4	1	1	1	1	0	0	0	0		
					3,997.00 €											
Rruga Anton Cefta (deri të trafës e rrymes)											Numri i aktiviteteve të ndërrmarra përgjatë periudhës së aktiviteteve të mirëmbajtjes					
Nr.	Përshkrimi i aktivitetit	nm	Sas z	Çmimi nm	Çmimi total (vjetor)	Nr. i aktiviteteve (vjetore)	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor		
1	Grumbullimi dhe largimi i mbeturinave (duke përfshirë edhe zbrazjen e shportave) sipas specifikimit teknik. Pastrimi duhet të bëhet në mënygjes.	Ari	40	0.10 €	740.00 €	185	25	25	25	25	25	25	25	10		
2	Pastrimi i grafitëve në sipërfaqet mureve. Pastrimi bëhet sipas specifikimit teknik sipas urdhërimit të menaxherit	m ²	5	0.01 €	0.20 €	4	1	1	1	1	0	0	0	0		
3	Mirëmbajtja e mobilierës urbane - Ulëset në rast të dëmtimit. Sipas specifikimit teknik dhe urdhërimit të menaxherit	Copë	2	0.01 €	0.08 €	4	1	1	1	1	0	0	0	0		
4	Mirëmbajtja e mobilierës urbane - Shportat në rast të dëmtimit. Sipas specifikimit teknik dhe urdhërimit të menaxherit	Copë	4	0.01 €	0.16 €	4	1	1	1	1	0	0	0	0		
					740.44 €											
Rruga 12 Qershorit (deri të furra)											Numri i aktiviteteve të ndërrmarra përgjatë periudhës së aktiviteteve të mirëmbajtjes					

Nr.	Përshkrimi i aktivitetit	nm	Sasia	Çmimi nm	Çmimi total (vijtor)	Nr. i aktiviteteve (vijtoresh)	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor
1	Grumbullimi dhe largimi i mbeturinave (duke përfshirë edhe zbrazjen e shportave) sipas specifikimit teknik. Pastrimi duhet të bëhet në mënyrë të menaxherit.	Ari	40	0.10 €	740.00 €	185	25	25	25	25	25	25	25	10
2	Pastrimi i grafitëve në sipërfaqet mureve. Urdhërit të menaxherit.	m ²	5	0.01 €	0.20 €	4	1	1	1	1	0	0	0	0
3	Mirëmbajtja e mobilierisë urbane - Ujëset në rast të dëmtimit. Sipas specifikimit teknik dhe urdhërit të menaxherit.	Copë	2	0.01 €	0.08 €	4	1	1	1	1	0	0	0	0
4	Mirëmbajtja e mobilierisë urbane - Shportat në rast të dëmtimit. Sipas specifikimit teknik dhe urdhërit të menaxherit.	Copë	2	0.01 €	0.08 €	4	1	1	1	1	0	0	0	0
					740.36 €									

Pruga Imer-Deveak

Numri i aktiviteteve të ndërmarrja përgjatë periudhës së aktiviteteve të mirëmbajtjes

Nr.	Përshkrimi i aktivitetit	nm	Sasia	Çmimi nm	Çmimi total (vijtor)	Nr. i aktiviteteve (vijtoresh)	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor
1	Grumbullimi dhe largimi i mbeturinave (duke përfshirë edhe zbrazjen e shportave) sipas specifikimit teknik. Pastrimi duhet të bëhet në mënyrë të menaxherit.	Ari	40	0.10 €	740.00 €	185	25	25	25	25	25	25	25	10
2	Pastrimi i grafitëve në sipërfaqet mureve. Urdhërit të menaxherit.	m ²	5	0.01 €	0.20 €	4	1	1	1	1	0	0	0	0
					740.20 €									

Sheshi Ahmet-Shtimie

Numri i aktiviteteve të ndërmarrja përgjatë periudhës së aktiviteteve të mirëmbajtjes

Nr.	Përshkrimi i aktivitetit	nm	Sasia	Çmimi nm	Çmimi total (vijtor)	Nr. i aktiviteteve (vijtoresh)	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor
1	Grumbullimi dhe largimi i mbeturinave (duke përfshirë edhe zbrazjen e shportave) sipas specifikimit teknik. Pastrimi duhet të bëhet në mënyrë të menaxherit.	Ari	44	0.10 €	814.00 €	185	25	25	25	25	25	25	25	10
2	Pastrimi i grafitëve në sipërfaqet mureve. Urdhërit të menaxherit.	m ²	5	0.01 €	0.20 €	4	1	1	1	1	0	0	0	0

3	Mirëmbajtja e mobiliterisë urbane - Ulëset në rast të dëmtimit. Sipas specifikimit teknik dhe urdhërit të menaxherit	Copë	2C	0.10 €	8.00 €	4	1	1	1	1	0	0	0	0
4	Mirëmbajtja e mobiliterisë urbane - Shportat në rast të dëmtimit. Sipas specifikimit teknik dhe urdhërit të menaxherit	Copë	2C	0.10 €	8.00 €	4	1	1	1	1	0	0	0	0
					830.20 €									

Sheshi Ujç														
Numri i aktiviteteve të ndërmarrja për gjatë periudhës së aktiviteteve të mirëmbajtjes														
Nr.	Përshkrimi i aktivitetit	nm	Sasia	Çmimi nm	Çmimi total (vjetor)	Nr. i aktiviteteve (vjetore)	Ma	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor
1	Grupullimi dhe largimi i mbeturinave (duke përfshirë edhe zbrazen e shportave) sipas specifikimit teknik. Pastrimi duhet të bëhet në mënyrë të përsosur.	Ari	0.9	1.00 €	166.50 €	385	25	25	25	25	25	25	25	10
2	Pastrimi i grafitëve në sipërfaqet mureve. Pastrimi bëhet sipas specifikimit teknik sipas urdhërit të menaxherit	m ²	2	0.01 €	0.08 €	4	1	1	1	1	0	0	0	0
					166.58 €									

Sheshi i Dërmorëve														
Numri i aktiviteteve të ndërmarrja për gjatë periudhës së aktiviteteve të mirëmbajtjes														
Nr.	Përshkrimi i aktivitetit	nm	Sasia	Çmimi nm	Çmimi total (vjetor)	Nr. i aktiviteteve (vjetore)	Ma	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor
1	Grupullimi dhe largimi i mbeturinave (duke përfshirë edhe zbrazen e shportave) sipas specifikimit teknik. Pastrimi duhet të bëhet në mënyrë të përsosur.	Ari	0.7	0.10 €	12.95 €	185	25	25	25	25	25	25	25	10
2	Pastrimi i grafitëve në sipërfaqet mureve. Pastrimi bëhet sipas specifikimit teknik sipas urdhërit të menaxherit	m ²	4	0.01 €	0.16 €	4	1	1	1	1	0	0	0	0
					13.11 €									

Shetitë e çyrtit														
Numri i aktiviteteve të ndërmarrja për gjatë periudhës së aktiviteteve të mirëmbajtjes														
Nr.	Përshkrimi i aktivitetit	nm	Sasia	Çmimi nm	Çmimi total (vjetor)	Nr. i aktiviteteve (vjetore)	Ma	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor

1	Grumbullimi dhe largimi i mbeturinave (duke përfshirë edhe zbrastimin e shportave) sipas specifikimit teknik. Pastrimi duhet të bëhet në mënyrë të menaxhert.	Ar	98	0.10 €	1,813.00 €	185	25	25	25	25	25	25	25	25	10
2	Mirëmbajtja e mobilierisë urbane - Ujëset në rast të dëmtimit. Sipas specifikimit teknik dhe urdhër-it të menaxhertit	Copë	2C	0.01 €	0.80 €	4	1	1	1	1	1	1	1	1	0
3	Mirëmbajtja e mobilierisë urbane - Shportat në rast të dëmtimit. Sipas specifikimit teknik dhe urdhër-it të menaxhertit	Copë	2C	0.01 €	0.80 €	4	1	1	1	1	1	1	1	1	0
					1,814.60 €										

Lumi Shtetërore

Numri i aktiviteteve të ndërmarrja përgjatë periudhës së aktiviteteve të mirëmbajtjes

Nr.	Përshkrimi i aktivitetit	nm	Sasia	Çmimi nm	Çmimi total (vjetor)	Nr. i aktiviteteve (vjetore)	Maj	Qershor	Çorrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor
1	Grumbullimi dhe largimi i mbeturinave sipas specifikimit teknik. Pastrimi duhet të bëhet në mënyrë të menaxhert.	m ³	900.0	0.10 €	7,920.00 €	88	10	12	12	12	12	12	10	8
2	Pastrimi i grafitave në sipërfaqet mureve. Pastrimi bëhet sipas specifikimit teknik sipas urdhër-it të menaxhertit	m ²	10	0.01 €	0.40 €	4	1	1	1	1	0	0	0	0
					7,920.40 €									

Parku të Qendra Elore

Numri i aktiviteteve të ndërmarrja përgjatë periudhës së aktiviteteve të mirëmbajtjes

Nr.	Përshkrimi i aktivitetit	nm	Sasia	Çmimi nm	Çmimi total (vjetor)	Nr. i aktiviteteve (vjetore)	Maj	Qershor	Çorrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor
1	Grumbullimi dhe largimi i mbeturinave (duke përfshirë edhe zbrastimin e shportave) sipas specifikimit teknik. Pastrimi duhet të bëhet në mënyrë të menaxhert.	Ar	250	0.10 €	2,755.00 €	95	10	15	15	15	10	10	10	10
2	Pastrimi i grafitave në sipërfaqet mureve. Pastrimi bëhet sipas specifikimit teknik sipas urdhër-it të menaxhertit	m ²	10	0.01 €	0.40 €	4	1	1	1	1	0	0	0	0
3	Mirëmbajtja e mobilierisë urbane - Ujëset në rast të dëmtimit. Sipas specifikimit teknik dhe urdhër-it të menaxhertit	Copë	15	0.01 €	0.60 €	4	1	1	1	1	0	0	0	0

4	Thyerja dhe demolimi i betonit eksitues, thyerja me makineri speciale.	m ²	5	0.10 €	0.50 €	1	0	0	0	0	0	1	0	0	0
5	Mirëmbajtja e mobilierisë urbane - Shportat në rast të dëmtimit. Sipas specifikimit teknik dhe urdhërit të menaxherit	Copë	15	0.01 €	0.60 €	4	1	1	1	1	0	0	0	0	0
					2,757.10 €										

Parku të shtezgimit dhe të jetës Hasanit															
Numri i aktiviteteve të ndërmarrja përgjatë periudhës së aktiviteteve të mirëmbajtjes															
Nr.	Përshkrimi i aktivitetit	nm	Sasia	Çmimi nm	Çmimi total (vjetor)	Nr. i aktiviteteve (vjetore)	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	
1	Grumbullimi dhe largimi i mbeturinave (duke përfshirë edhe zbrazjen e shportave) sipas specifikimit teknik. Pastrimi duhet të bëhet në mëngjes.	Ari	3	0.10 €	28.50 €	95	10	15	15	15	10	10	10	10	
2	Pastrimi i grafitëve në sipërfaqet mureve. Pastrimi bëhet sipas specifikimit teknik sipas urdhërit të menaxherit	m ²	5	0.01 €	0.05 €	1	0	0	0	1	0	0	0	0	
3	Mirëmbajtja e mobilierisë urbane - Ulëset në rast të dëmtimit. Sipas specifikimit teknik dhe urdhërit të menaxherit	Copë	4	0.01 €	0.16 €	4	1	1	1	1	0	0	0	0	
4	Kostija e barit brenda hapësirave rreth lapidarit.	Ari	3	5.00 €	15.00 €	1	0	0	0	0	1	0	0	0	
5	Mirëmbajtja e mobilierisë urbane - Shportat në rast të dëmtimit. Sipas specifikimit teknik dhe urdhërit të menaxherit	Copë	2	0.01 €	0.08 €	4	1	1	1	1	0	0	0	0	
					43.79 €										


Parku të shtezgimit dhe të jetës															
Numri i aktiviteteve të ndërmarrja përgjatë periudhës së aktiviteteve të mirëmbajtjes															
Nr.	Përshkrimi i aktivitetit	nm	Sasia	Çmimi nm	Çmimi total (vjetor)	Nr. i aktiviteteve (vjetore)	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	
1	Grumbullimi dhe largimi i mbeturinave (duke përfshirë edhe zbrazjen e shportave) sipas specifikimit teknik. Pastrimi duhet të bëhet në mëngjes.	Ari	2	0.80 €	152.00 €	95	10	15	15	15	10	10	10	10	


2	Pastrimi i grafitëve në sipërfaqet mureve. Pastrimi bëhet sipas specifikimit teknik sipas urdhërimit të menaxherit	m ²	8	0.01 €	0.08 €	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0
3	Mirëmbajtja e mobilierësë urbane - Ulëset në rast të dëmtimit. Sipas specifikimit teknik dhe urdhërimit të menaxherit	Copë	2	0.10 €	0.80 €	4	1	1	1	0	0	0	0	0	0
4	Mirëmbajtja e drunjeve dekorativ tek parku i shtëpisë së kultures si dhe përgjatë rruges Skender Salihaj	Copë	30	0.10 €	18.00 €	6	1	1	1	1	1	1	0	0	0
5	Kosija e barit në hapësirat e parkut të shtëpia e kultures si dhe përgjatë rruges Skender Salihaj deri tek kisha	Ari	3	5.00 €	15.00 €	1	0	0	0	0	1	0	0	0	0
6	Mirëmbajtja e mobilierësë urbane - Shportat në rast të dëmtimit. Sipas specifikimit teknik dhe urdhërimit të menaxherit	Copë	2	0.01 €	0.08 €	4	1	1	1	0	0	0	0	0	0
					185.96 €										

Pastrimi i gjypave ekzistues të kanalizimit atmosferik						
Nr.	Përshkrimi i aktivitetit	mm	Sesla	Çmimi mm	Çmimi total	
1	Pastrimi i gjypave ekzistues të kanalizimit atmosferik me diameter të ndryshëm nga 1300 deri 11000. Pastrimi të bëhet me makineri speciale. Ky pozicion realizohet vetëm në kërkesë të menaxherit kur të paraqitet nevoja.	m1	290	0.38 €	110.20 €	
					110.20 €	

Rekapitullimi	
1	Rruga Adem Jashari 11,212.84 €
2	Rruga Tahir Sinani 10,725.80 €
3	Rruga Komandant Kumanova 5,997.80 €
4	Rruga Anton Qetta (deri të trafa e rrymes) 740.44 €
5	Rruga 12 Qershorit (deri të furra) 740.56 €
6	Rruga Imer Devetaku 740.20 €
7	Sheshi Ahmet Shkirimja 850.10 €
8	Sheshi UÇK 1,565.58 €

9	Sheshi I Deshmoreve	12.11 €
10	Shetitorja e qytetit	1.812.60 €
11	Lumi Shtimjania	7.920.40 €
12	Parku të Qendra Minore	2.757.20 €
13	Parku të shtatorja e heroi: Jeti,ë Hasani	42.79 €
14	Parku të shtrepi e kultures	25.96 €
15	Pastrimi i gypave eksistues të kanalizimit atmosferik	210.20 €
		41,996.98 €

Emri i Kompanisë	NNSH XHEMA COM
Adresa e Plote	Gadime e Eperme-Lipjan
Perfaqesuar Nga:	
Emri & Mbledhri	Xhemshir Sejdija
Pozita	Drejtor
Nenshkrimi	
Data	06.06.2023
Vula	





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA SHTIME
OPŠTINA ŠTIMLJE/MUNICIPALITY OF SHTIME



Drejtoria për Planifikim Urban, Kadastër dhe Gjeodezi
Uprava za Urbanizam, Katastar i Geodeziju
Department of Urban Planning, Cadastre and Geodesy

Data/Datum/Date:	29.06.2023
Nr./Br./No	06/98
Për/Za/To:	Drejtorinë e Prokurimit Drejtor, Jeton Raka
Nga/Od/From:	Drejtoria për Planifikim Urban, Kadastër dhe Gjeodezi Drejtor, Grejtalo Emini
Lënda/Predmet/Subject :	Vendim, për Menaxher të Kontratës dhe mbikëqyrës të drejtpërdrejtë të Menaxherit të Kontratës

Në bazë të nenit 81 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Lgjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, nenit 9 paragrafi 1 pika g), si dhe nenit 61 të Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik, i datës 01.02.2021, dhe Vendimit të ZKA nr. 02/70, të datës 25.03.2022 për autorizim për emërimin e menaxherëve dhe mbikëqyrësve të kontratave. Drejtoria për Planifikim Urban, Kadastër dhe Gjeodezi merr këtë:

VENDIM

1. Emërohet Menaxheri i kontratës dhe Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i Kontratës për kontratën: **“Mirëmbajtja e pastertisë grumbullimi dhe largimi i mbeturinave, “**
2. Menaxher i Kontratës: **z. Gojart Bajrami**
3. Emërohet Mbikëqyrës i drejtpërdrejtë i Menaxherit të Kontratës: **z. Bardhyl Rushiti - Drejtori I SHP**
4. Menaxheri i kontratës, dhe Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i Menaxherit të Kontratës obligohen që të bëjnë administrimin dhe menaxhimin e implementimit të kontratave në pajtim me Rregullat dhe Udhëzuesin Operativ për Prokurimin Publik, si dhe Manualët për Përdorim të Modullit për Menaxhim të Kontratës,

Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.
I'u dorëzohet:

1. Menaxherit të Kontratës;
2. Mbikëqyrësit të Menaxherit të Kontratës;
3. Zyrës së Kryetarit;
4. Drejtorisë së Prokurimit.